

B²-InF



INFERTILITETI DHE RIPRODHIMI ME ASISTENCË MJEKËSORE.

Mbyllja e hendekut mes shqetësimeve të qytetarëve dhe informacionit të ofruar nga klinikat.



Funded by
the European Union

TABELA E PËRMBAJTJES

01	ABSTRAKT	03
02	INFERTILITETI	04
03	INFORMOHUNI MË MIRË PËR FERTILITETIN	05
04	REZULTATET B2-INF	06
05	REKOMANDIME PËR NJË SHOQËRI TË MIRËINFORMUAR	07
06	PËRFUNDIME	09

Infertiliteti është një çështje kritike e shëndetit publik që prek miliona individë dhe çifte në mbarë botën dhe mund të ndikojë seriozisht në cilësinë e jetës së tyre. Në Shqipëri, disa faktorë, nga papunësia e lartë e të rinjve deri tek rritja e nivelit të arsimit të grave dhe pjesëmarrja e tyre në tregun e punës, kanë ndikuar në uljen e shkallës së lindshmërisë vitet e fundit, por ende mbetet mbi mesataren evropiane. Në këtë kontekst, infertiliteti dhe kujdesi për fertilitetin bëhen çështje edhe më të rëndësishme. Megjithatë, njohuritë e përgjithshme për infertilitetin dhe trajtimet e tij janë të pakta dhe informacioni i dhënë nuk komunikohet gjithmonë siç duhet. Gjuha teknike dhe të dhënat çorientuese (p.sh. normat e suksesit të trajtimeve të fertilitetit) shpesh e pengojnë publikun e gjerë të bëjë zgjedhje të mirëinformuara. Projekti B2-INF ka eksploruar perceptimet dhe përvojat e të rinjve shqiptarë për infertilitetin dhe trajtimet e tij nëpërmjet intervistave, duke analizuar informacionin e dhënë nga klinikat dhe duke eksploruar rregullimet ligjore të vendit. Si rezultat i të gjitha analizave të kryera, B2-INF ofron rekomandime dhe udhëzime për të kapërcyer hendekun midis shqetësimeve dhe pritshmërive të publikut në lidhje me riprodhimin me asistencë mjekësore dhe kujdesin për fertilitetin, si dhe informacionin dhe shërbimet e ofruara nga klinikat.

NJË ÇËSHTJE KRITIKE E SHËNDETIT PUBLIK.

Organizata Botërore e Shëndetësisë konstaton se infertiliteti është një problem shëndetësor global që prek rreth 48 milionë çifte dhe 186 milionë individë në mbarë botën (1). Vështirësia për të pasur fëmijë mund të ketë efekte të rëndësishme sociale, ekonomike, psikologjike dhe fizike që ndikojnë seriozisht në cilësinë e jetës së njerëzve në fjalë. Për më tepër, ka pabarazi të konsiderueshme sociale në përhapjen, diagnostikimin dhe trajtimin e infertilitetit, si dhe rreziqe shëndetësore për gratë, burrat dhe pasardhësit e tyre të lidhura me këto trajtime (2). Veç kësaj, faktorët social-kulturorë dhe mjedisorë, si rritja e moshës mesatare të shtatzënisë në popullatën e përgjithshme, ka të ngjarë të përforcojnë rëndësinë sociale të kësaj çështjeje tashmë të rëndësishme. Për të gjitha këto arsye, dhe për shkak se kujdesi riprodhues është kyç për promovimin e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese, infertiliteti dhe rezultatet e tij janë bërë një çështje kritike e shëndetit publik.

Në Shqipëri, shkalla e lindshmërisë ka pësuar rënie të lehtë vitet e fundit në më pak se 1.6 fëmijë për grua (3), dhe mosha mesatare e grave në lindjen e parë ishte 22 vjeç në 2018, e cila mund të jetë edhe më e re në mesin e grave nga zonat rurale, ato me nivel më të ulët ekonomik dhe në popullsinë myslimane (4).

Që nga viti 2002, asnjë rregullore nuk është miratuar për të zbatuar dispozita të veçanta ligjore për riprodhimin me asistencë mjekësore (RAM). Për shkak të kësaj mungese në rregullore, situata ligjore në Shqipëri karakterizohet nga paqartësi në lidhje me statusin e dhuruesit, të drejtat e fëmijës dhe veçanërisht kriteret e vendosura nga ofruesit shëndetësorë për përdoruesit (5).

Janë 11 klinika në vend që kryejnë trajtime RAM dhe të gjitha janë private. Qeveria

e Shqipërisë nuk ofron fonde publike për këtë lloj trajtimi dhe nuk ka një regjistër kombëtar të aktivitetit të RAM në vend. Shqipëria është një destinacion për kujdesin riprodhues ndërkufitar, por shqiptarët po udhëtojnë gjithashtu edhe në vende të tjera, veçanërisht në Greqi dhe Maqedoni, për të përdorur RAM.

Fatkeqësisht, njohuritë e përgjithshme rreth infertilitetit dhe trajtimeve RAM janë të pakta dhe informacioni lidhur me këtë trajtim nuk komunikohet gjithmonë siç duhet.

INFORMOHUNI MË MIRË PËR FERTILITETIN

PROJEKTI KËRKIMOR B2-INF

Projekti kërkimor "Informohuni më mirë rreth infertilitetin -B2-InF-", i financuar nga Bashkimi Evropian, u krijua për të eksploruar njohuritë, pritshmëritë dhe shqetësimet e të rinjve të moshës 18 deri në 30 vjeç dhe informacionin e dhënë nga klinikat e Riprodhimit me Asistencë Mjekësore (RAM) nga 8 vende europiane, përfshirë edhe Shqipërinë, me objektivin përfundimtar ofrimin e rekomandimeve për të përafuar shërbimet, kërkimin dhe informacionin e klinikave RAM me pikëpamjet, shqetësimet dhe pritshmëritë e qytetarëve të rinj.

Për të arritur këtë objektiv, në Shqipëri u kryen 11 intervista me të rinj dhe u ekzaminuan faqet e internetit të 5 klinikave. Transkriptet e intervistave dhe informacioni i mbledhur nga klinikat u analizuan duke ndjekur qasje cilësore nga perspektiva social-kulturore dhe gjinore. Gjithashtu, është bërë një analizë dokumentare për të konstatuar rregullimin ligjor të RAM në vend. Bazuar në njohuritë e gjeneruara, ekipi kërkimor B2-InF ka përpunuar rekomandimet e përmbledhura në këtë dokument për Shqipërinë, si dhe udhëzime specifike për shtatë vendet e tjera të përfshira në projektin B2-

InF (Belgjikë, Itali, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Slloveni, Spanjë, Zvicër) dhe rekomandimet globale. Të gjitha këto dokumente janë të disponueshme në faqen e internetit të projektit B2-InF.

SHQETËSIMET DHE INFORMACIONI NUK PËRPUTHEN SIÇ DUHET

Në përgjithësi, të rinjtë evropianë e shohin të favorshëm Riprodhimin me Asistencë Mjekësore (RAM) si një opsion të mirë për të trajtuar problemet e infertilitetit, duke shprehur perceptime pozitive për to pavarësisht mungesës së njohurive dhe duke mbështetur barazinë e aksesit për të gjithë. Megjithatë, të rinjtë evropianë shprehin gjithashtu shqetësime për çështje kritike që lidhen me RAM. Kryesisht, u ngritën shqetësime për lidhjen e ngushtë midis infertilitetit dhe presionit social përsa i përket roleve gjinore. Ndërsa infertiliteti dhe veçanërisht infertiliteti mashkullor mbeten tabu për shkak të mungesës së njohurive për përhapjen dhe shkaqet e tyre në shoqëri, një faj, barrë dhe përgjegjësi e padrejtë për infertilitetin i atribuohet grave nga shoqëria. Për më tepër, pabarazitë e aksesit në trajtimet RAM për disa grupe të popullsisë, kryesisht për shkak të kostove, përshkruhen si barriera për t'u zgjidhur. Së fundi, të rinjtë shprehin shqetësimin për besueshmërinë e informacionit të ofruar nga klinikat private për shkak të interesave të perceptuara komerciale që mund të ndikojnë në cilësinë e këtyre të dhënave. Në veçanti, të rinjtë evropianë shprehin një dëshirë të qartë për të rritur disponueshmërinë e informacionit të aksesueshëm, të qartë dhe të besueshëm në lidhje me normat e suksesit të RAM, rreziqet dhe mbështetjen e kujdesit psikologjik.

Për sa i përket informacionit të ofruar nga klinikat, faqet e internetit të eksploruara paraqesin një sasi të madhe informacioni me një tepriçë të termave teknike dhe shkencorë pa interpretime të thjeshta gjuhësore, duke penguar kështu kuptimin e tij nga popullata e përgjithshme. Veç kësaj, informacioni për normën e suksesit dhe rreziqet nuk paraqitet gjithmonë në mënyrë specifike dhe të qartë. Për më tepër, informacioni në lidhje me shërbimet e trajtimit të infertilitetit dhe burimet e marketingut të përdorura për

të paraqitur këtë informacion, janë të drejtuara kryesisht drejt çifteve të bardha dhe heteroseksuale dhe anojnë drejt grave, të cilat mund të kontribuojnë në barrën e pabarabartë sociale të infertilitetit femëror.

Për më tepër, megjithëse informacioni i ofruar nga klinikat RAM rregullohet me standarde ligjore për reklamim të vërtetë, klinikat jo gjithmonë i përmbushin këto standarde. Në veçanti, faqet e internetit të klinikave shpesh nuk kanë transparencë në lidhje me kostot e trajtimit të RAM dhe jo gjithmonë ofrojnë informacion në lidhje me normat e suksesit dhe trajtimet shtesë (procedurat suplementare të ofruara nga klinikat me qëllim përmirësimit e rezultateve të trajtimit të fertilitetit) dhe rreziqet e mundshme, ose e bëjnë këtë në mënyra që janë çorientuese ose të vështira për t'u kuptuar.

Lidhur me kuadrin e dobët ligjor të Shqipërisë, u identifikuan disa dobësi, kryesisht Ligji 8876 për Shëndetin Riprodhues ka nevojë të përditësohet në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ); nuk ka komision kombëtar për mbikëqyrjen e RAM; megjithëse kontratat e surrogacisë konsiderohen të pavlefshme dhe ligji shqiptar përcakton prejardhjen në favor të gruas që lind, Shqipëria është kthyer në një destinacion të zakonshëm për programet e surrogacisë ndërkufitare me origjinë nga Rusia dhe Ukraina; mungesa e qartësisë për aksesin; kufizimi ligjor nuk merr parasysh faktin që sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, çiftet që bartin sëmundje gjenetike duhet t'u garantohet akses; asnjë ligj nuk përcakton në mënyrë specifike detyrimin për të raportuar mbi RAM, mospërputhje të mundshme midis të drejtës së fëmijës për të njohur origjinën biologjike dhe anonimitetit të donatorëve; asnjë rregullore e detajuar e pëlqimit të informuar.

REKOMANDIME PËR NJË SHOQËRI TË MIRËINFORMUAR

REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR KLINIKAT DHE QEVERITË

Për të informuar më mirë qytetarët për infertilitetin dhe RAM, **klinikat duhet të për afrojnë informacionin që ofrojnë me shqetësimet dhe pritshmëritë e publikut, duke përbushur në çdo mënyrë standardet ligjore** për reklamim të vërtetë. Me qëllim luftimin e stigmës rreth infertilitetit dhe promovimin e trajtimeve cilësore RAM, qeveritë duhet të bëjnë përpjekje për të zhvilluar dhe **implementuar fushata publike** për të

rritur ndërgjegjësimin dhe për të edukuar më mirë popullatën e përgjithshme rreth infertilitetit, shkaqeve dhe trajtimeve të tij, me fokus në paragjykimet dhe keqkuptimet gjinore, dhe për të kontrolluar **përbushjen e rregulloreve ligjore përkatëse për shërbimet shëndetësore dhe reklamat.**

REKOMANDIME SPECIFIKE

- **Informacioni i ofruar duhet të ndihmojë në reduktimin e tabuve sociale, të luftojë stigmën rreth infertilitetin dhe të shmangë paraqitjen e tij si një çështje të grave.** Informacioni duhet të jetë i balancuar sipas gjinisë dhe duhet të përdorë ngjyra, gjuhë dhe logo neutrale ndaj gjinisë. Klinikat duhet të qartësojnë pacientët e ardhshëm përballë pikëpamjes kritike të shoqërisë ndaj RAM.
- **Mëmësia dhe prindërimi nuk duhet të paraqiten si kusht për lumturinë në jetë dhe klinikat duhet të shmangin prezantimin e tyre si “lehtësues ëndrrash”.** Rekomandohet fort që të shmangen superlativat kur përshkruhen shërbimet e klinikave RAM për të reduktuar shpresat e rreme dhe për të ulur presionin social.
- **Informacioni (përmbajtje dhe vizuale) i ofruar duhet të jetë gjithëpërfshirës nga ana gjinore, më pak i përqendruar te femra, më pak heterocentrik dhe i synuar për një popullsi më të larmishme etnike.** Strategjitë e reklamave dhe informacionet të ofruara nga klinikat dhe autoritetet shëndetësore duhet t’u drejtohen të gjithë prindërve të mundshëm dhe atyre që kontribuojnë në riprodhim (p.sh. donatorët), pavarësisht nga gjinia, orientimi seksual ose paaftësia dhe duke reflektuar diversitetin etnik, kulturor dhe racor të Shqipërisë.
- **Informacioni i ofruar nga klinikat duhet të jetë më objektiv, i besueshëm, i kuptueshëm, i qartë dhe i aksesueshëm për publikun e gjerë dhe pacientët, në mbështetje të kuptimit adekuat dhe zgjedhjeve të mirëinformuara.** Ai duhet të bazohet në provat më të mira shkencore të disponueshme, duke ofruar burime të dhënash të bazuara në evidenca dhe

duhet të ofrojë shpjegime në terma jo teknikë. Faqet e internetit të klinikave duhet të jenë më të thjeshta dhe të shmangin kontradiktat.

- **Për të reduktuar keqkuptimet dhe shpresat e rreme dhe për të promovuar zgjedhje të informuara**, klinikat duhet të përdorin një gjuhë të kuptueshme, të qartë, homogjene dhe të përbashkët kur **japin informacion në lidhje me koston, kohëzgjatjen, normën e suksesit** (rekomandohet të zbulohen normat e lindjeve të gjalla, jo vetëm normat e shtatzënisë), **rreziqet e mundshme shëndetësore** për secilën teknikë RAM (duke marrë në konsideratë gjininë dhe moshën e përdoruesve) **dhe sfidat psikologjike**.
- Klinikat duhet të jenë **transparente në lidhje me kushtet për marrjen e mbështetjes nga qeveria, të drejtat** që implikohen nga trajtimi i fertilitetit dhe **përkufizimet ligjore** të të qenit prindër.
- Klinikat duhet të ofrojnë **informacion në lidhje me alternativat** ndaj RAM, duke përfshirë adoptimin .
- Autoritetet shëndetësore duhet të promovojnë aksesin në **“fletat e informacionit”** dhe **“format e pëlqimit të informuar”**. Sugjerohet krijimi i një **katalogu të këtyre dokumenteve** që janë në përputhje me rregulloret aktuale. Duhet të krijohet gjithashtu një regjistër kombëtar i klinikave, duke ofruar informacion të standardizuar për normat e suksesit.

PËRFUNDIME

Kujdesi për fertilitetin është i një rëndësie kyçe në Shqipëri, duke përmendur kuadrin e dobët ligjor për shëndetin riprodhues. Ka vend për përmirësimin e informacionit të ofruar nga klinikat RAM dhe gjithashtu nga autoritetet shëndetësore shqiptare në mënyrë që të adresohen shqetësimet dhe pritshmëritë e publikut të gjerë në lidhje me kujdesin për fertilitetin, riprodhimin me asistencë mjekësore dhe shërbime të tjera të ofruara nga klinikat shqiptare. Rekomandohet fort zbatimi i rekomandimeve të prodhuara nga B2-INF për të promovuar njohuri më të mira për infertilitetin dhe trajtimet e tij, me

qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, uljen e stigmatizimit dhe ofrimin e informacionit të besueshëm, të kuptueshëm dhe të qartë për publikun e gjerë dhe pacientët dhe kjo do të kontribuojnë në zgjedhje të mirëinformuara. Udhëzimet e zgjeruara janë të disponueshme në faqen e internetit të projektit B2-INF.

REFERENCA

1. World Health Organization. Infertility [Internet]. World Health Organization [accessed 16 December 2022]. Available from: <https://www.who.int/health-topics/infertility>
2. Centers for Disease Control and Prevention. National Public Health Action Plan for the Detection, Prevention, and Management of Infertility. Atlanta, Georgia: Centers for Disease Control and Prevention; June 2014. Available from: https://www.cdc.gov/reproductivehealth/infertility/pdf/drh_nap_final_508.pdf
3. Fertility rate, total (births per woman) - Albania | Dating [Internet]. [cited 2022 Jan 24]. Available from: <https://data.worldbank.org/indicator/SP.DYN.TFRT.IN?locations=AL>
4. Talukder A, Khan ZI, Khatun F, Tahmida S. Factors associated with age of mother at first birth in Albania: application of quantile regression model. Helyon [Internet]. 2021 Mar 1 [cited 2022 Jan 24];7(3):e06547. Available from: <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2405844021006502>
5. Calhaz-Jorge C, De Geyter CH, Kupka MS, et al. Survey on ART and IUI: legislation, regulation, funding and registries in European countries: The European IVF-monitoring Consortium (EIM) for the European Society of Human Reproduction and Embryology (ESHRE). Hum Play Open 2020(1): hoz044. doi:10.1093/hropen/hoz044

INFORMACION I KONTAKTIT

Faqja e internetit e B2-Inf
www.b2-inf.eu

Drejtues projekti
Francisco Güell

Email
B2-inf@unav.es

Numër telefoni
+34 948425600 ext803217

REDES SOCIALES

Twitter
[@b2inf_](https://twitter.com/b2inf_)

LinkedIn
[/b2-inf-h2020-project](https://www.linkedin.com/company/b2-inf-h2020-project)



Funded by
the European Union